



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1894/8 Prot.

Patos më 04.07.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 30.06.2025

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Armand Ahmetaj
2. Klaudio Alisinanaj
3. Erald Çepele
4. Lori Musaj
5. Artan Velçani
6. Klarida Semanjaku
7. Ertilla Myrtaj
8. Suela Hoxha
9. Smerald Hazizaj
10. Elmira Rama
11. Vjollca Kasaj
12. Novrus Toska
13. Zejni Musaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përsëndetje të gjithëve!

Të nderuar këshilltarë!

I nderuar Kryetar i Bashkisë!

Zhvillojmë mbledhjen e radhës e këshillit bashkiak e cila bazohet në neni 53 pika 4 dhe 56 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit është 13 këshilltarë.

Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës.

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 13.06.2025.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 13.06.2025.

4-Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin maj 2025”.

5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin maj 2025”.

6- Projekt-vendim “Për miratimin e projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm, faza e parë 2026-2028”.

7- Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit vjetor të konsolidimit të buxhetit dhe Performancës 2024”.

8- Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga “Fondi i Kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, në vlerën 45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë për z. Ferko Xhelaj banesa e të cilit është dëmtuar nga renia e zjarrit, lagjja 1Maj”.

9-Projekt-vendim “Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2025”.

10- Projekt-vendim “Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027”.

11- Projekt-vendim “Për një ndryshim të vendimit nr. 74, datë 28.10.2024, “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijëve administrativo-territoriale për Bashkinë Patos”.

12- Projekt-vendim “Për miratimin e blerjes së mjetit “autobetoniere për nevojat e Agjencisë së Shërbimeve Publike”.

Dua t’ju informoj se rendi i ditës është ndërtuar në bazë të rregullores dhe ligjit gjithashtu projektvendimet kanë kaluar për shqyrtim në komisionet përkatëse të cilat për çdo pikë do të relatojnë opinionin e tyre.

Kalojmë në miratimin e rendit e ditës.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj



Zoni Musaj  
Smerold. Hoxhaj  
Ertan Myrtaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1894 / 19 Prot.

Patos më 09 .07.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 13.06.2025.

Armand Ahmetaj – Kemi ndonje vërejtje?

Klaudio Alisinanaj- Përshëndetje të gjithëve!

Është bërë një lapsus, emri këshilltarit Zejni Musaj është shënuar dy here, në prezencën e këshilltarëve.

Erald Çepele- Nuk është shënuar emri im. Korrigjoje!

Armand Ahmetaj- vërejtje me vend- Të korrigjohet

Nese skemi gjë tjetër ezaurohet pika 2 në bazë të nenit 77 pelqimi unanim.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Lori Musaj Haf  
Smerald Hazro  
Ertilo Myrtaj Çepelaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1894 Prot.  
10

Patos më, 04 07.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 13.06.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 13.06.2025 u mor gjithsej 1 vendim. Vendimi nr. 28

Vendimi është zbardhur në afat dhe i është përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

Lori Musaj  
Smeralda Hoxha  
Gëzika Myrtaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1889 / 3 Prot.

Patos më 04 07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Maj 2025”.

Armand Ahmetaj- Ekzekutivi relaton!

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social- Projekt-vendim nr. 31 datë 20.06.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Maj 2025”.

Ekzekutivi i propozon Këshillit të Bashkisë Patos të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Maj 2025 gjithsej 21 familje me një fond prej 86,847 (tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e dyzetë e shtatë) lekë. Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Lori Musaj, Kryetare e komisionit të Ekonomisë– - Përsëritet të gjithëve! Komisioni Ekonomisë është mbledhur dhe ka diskutuar mbi këtë projektvendim për të cilin konstaton se është në përputhje me bazën ligjore dhe ka vendosur ta miratoi pa asnjë ndryshim duke votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Jemi të hapu për diskutime. Kush e do fjalën?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Maj 2025”.

Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

*Lori Musaj*  
*Smereta Hoxha*  
*Erkida Myrtaj*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1899 Prot.

13

Patos më 09 07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Maj 2025”.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social-

Projekt-vendim nr. 32 datë 20.06.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Maj 2025”.

Ekzekutivi i propozon Këshillit të Bashkisë Patos të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Maj 2025 gjithsej 17 familje me një fond prej 69,496 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Lori Musaj, Kryetare e komisionit të Ekonomisë – Gjatë mbledhjes së komisionit të ekonomisë është diskutuar dhe mbi këtë projektvendim ku është konstatuar se është në përputhje me bazën ligjore dhe kemi vendosur ta miratojmë pa asnjë ndryshim duke votuar me dy vota pro dhe një kundër.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Maj 2025”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

*Lori Musaj*  
*Smereta Hoxhaj*  
*Erdita Myrtaj*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA PATOS**  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1891/3 Prot.

Patos më 04.07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm, faza e parë 2026-2028”.

Armand Ahmetaj- Moza Fjalën!

Mimoza Shtëmbari – Drejtore Financës.

Mbas gjithë ecurisë projektbuxheti afatmesëm është një dokument që fillon që në mars me miratimin e burimeve financiare të të ardhurave vendore dhe vazhdon me miratimin e fazës së parë, miratimin e tavaneve përfundimtare, buxhetin e rishikuar dhe buxhetin përfundimtar. Sot kemi paraqitur projektvendimin për miratimin e dokumentit të fazës së parë afatmesëm 2026-2028. Në këtë dokument janë përshkruar saktë dhe drejtë burimet dhe shpenzimet. Peshat Specifike që zë çdo burim, investimet prioritare, objektivat dhe aktivitetet për çdo program, peshat specifike e çdo programi të dokumentuara hap pas hapi dhe në mënyrë të detajuar në dokumentin e paraqitur bashkëngjitur projektvendimit.

Kërkojmë të miratohet projektdokumenti i parë buxheti afatmesëm 2026-2028.

Këtu është dhe trendi i shpenzimeve ku ekzekutivi ka marrë parasysh të gjitha konsultimet dhe dëgjuesat publike dhe shpenzimet kapitale në rritje.

Lori Musaj Kryetare e komisionit të Ekonomisë– Edhe ky projektvendim është diskutuar gjatë mbledhjes së komisionit të cilin e konstatoi në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me katër vota pro.

Armand Ahmetaj – Kalojmë në votim e pikës gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm, faza e parë 2026-2028”.

Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, ska kundër , abstenim ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Lori Musaj

Smerdet Haxhi  
Eshita Myrtaj  
Cajupaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1842 / 14 Prot.

Patos më 04 07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit vjetor të konsolidimit të buxhetit dhe Performancës 2024”.

Mmimoza Shtëmbari- Drejtore Financës.

Ky projektvendim vjen mbas tre raporteve të monitorimit dhe performancës që kanë kaluar në këshill gjatë fazave sipas ligjit dhe rregullores të zbatimit të buxhetit. Mbasi është bërë konsolidimi i pasqyrave financiare ku gjithë aktiviteti bashkisë ka kaluar në konsolidim në nxjerjen e pasqyrave financiare ose bilanci me gjithë njësitë shpenzuese ekzekutivi ka hartuar raportin e konsolidimit dhe të performancës i cili përmban në mënyrë të përmbledhur tre raportet e monitorimit që është vjetor dhe pasqyrat financiare të konsoliduara.

Gjithashtu ky raport duhet të raportojë edhe rekomandimet e auditit të jashtëm në këtë rast të KLSH dhe pjesë e këtij raporti. Në fazën ku jemi në rekomandime nga KLSH nuk na kanë ardhur akoma për fazën e auditimit të vitit 2024.

Në këtë raport janë të gjithë tregueset e realizimit, mos realizimit dhe konsolidimi i gjithë aktiveve dhe vlerave monetare të trashëguara.

Ky është në mënyrë të përmbledhur, materiali i detajuar është paraqitur dhe në komision i cili do të publikohet të do të jetë në faqen e webit në faqen e bashkisë.

Propozoi për miratim të raportit konsoliduar dhe performancës për vitin 2024.

Lori Musaj, Kryetare e komisionit të Ekonomisë – Në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe ky projektvendim të cilin e kemi argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe kemi votuar me katër vota pro faleminderit.

Armand Ahmetaj – Kalojmë në votim e pikës shtatë Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit vjetor të konsolidimit të buxhetit dhe Performancës 2024”.

Armand Ahmetaj – Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1731/16 Prot.

Patos më 09.07.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës. Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga “Fondi i Kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, në vlerën 45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë për z. Ferko Xhelaj banesa e të cilit është dëmtuar nga renia e zjarrit, lagjja 1 Maj”.

Ekzekutivi relatton materailin.

Arben Shpërdheja - Projektvendim nr. 28 datë 18.06.2025 “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga “Fondi i Kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, në vlerën 45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë për z. Ferko Xhelaj banesa e të cilit është dëmtuar nga renia e zjarrit, lagjja 1 Maj”.

Z. Ferko Xhelaj ka paraqitur kërkesën me nr. 1731 prot., datë 04.06.2025, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesë në lagjen “1 Maj” nga rënia e zjarrit dhe për ndihmë financiare për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetarit është ngritur komisioni me urdhërin nr.118, nr.1731/1 prot., datë 10.06.2025

Komisioni pasi bëri verifikimin në vend të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. Ferko Xhelaj mbajti procesverbalin. Nga procesverbali i verifikimit në vend rezulton se janë djegur:

Vetrat durali 11 m<sup>2</sup>, 1(një) frigorifer dhe 1(një) aspirator.

U hartuar edhe preventivi për punimet që duhet të kryhen në banesë në vlerën 128,848. (njëqindë enjëzetë e tetë mijë e tetëqindë e dyzetë e tetë) lekë, referuar edhe “Vërtetimit për rënie zjarri” nr. 1 të datës 30.05.2025 lëshuar nga MZSH Patos që vërteton rënien e zjarrit. Në bazë të V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” të dëmtuarit i jepet ndihmë financiare 50% e vlerës.

Bazuar në V.K.M-në nr. 414, dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” (i ndryshuar) pika 3.1 shkronja “a” me qëllim për të ndihmuar Z. Ferko Xhelaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, t’i jepet një ndihmë financiare në vlerën 45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë.

Kërkojmë miraimin e këtij projektvendimit

Lori Musaj, Kryetare e komisionit të Ekonomisë— Në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe ky projektvendim të cilin e kemi argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe kemi votuar më katër vota pro për dhënie të ndihmës për qytetarin. Ftoj kolegët ta miratojmë.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga “Fondi i Kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, në vlerën 45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë për z. Ferko Xhelaj banesa e të cilit është dëmtuar nga renia e zjarrit, lagjja 1 Maj”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1886 Prot.  
13

Patos më 09.07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Mbi transferimin e vlerave të aktiveve në kontabilitet, në shoqërinë rajonale ujësjellës kanalizime Fier”.

Mmimoza Shtëmbari- Drejtore Financës.

Ky projektvendim ka të bëjë me transferimin e vlerave të aktiveve, në shoqërinë rajonale ujësjellës kanalizime Fier”.

Këto janë disa ujësjellsa të transferuara nga njësitë që na u bashkuan Zharrës dhe Ruzhdie për të cilat ujësjellsa i tarifon por me shkresën nr. 30 të nisur për transferim në shoqërinë e ujësjellësit na është kthyer përgjigje nga ekspertët që po bëjnë bashkimin i cili është në fazën përfundimtare që këto transferime duhen me një vendim të këshillit. Objektet janë të listuara në projektvendim, kanë amorizimin kanë nga kush na është transferuar në bashkinë tonë dhe vlerën historike. Vlera është 99 milion e 794 sipas përkatësisë së ujësjellsave të listuar në projektvendim. Duke qënë se ne jemi aksioner të shoqërisë aksionere e çuam transferimin në rrugë zyrtare pasi ata i tarifojnë siç i përmenda dhe më përpara. Ata kërkojnë dhe një vendim këshilli në bazë të ekspertëve kontabël që kanë për vlerësimin dhe përfundimin e bashkimit.

Lori Musaj, Kryetare e komisionit të Ekonomisë – Edhe ky projektvendim kaloi në mbledhjen e komisionit të cilin e kemi argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe kemi votuar më katër vota pro.

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje? Nëse nuk kemi kalojmë në votim e pikës së nëntë Projekt-vendim Mbi transferimin e vlerave të aktiveve në kontabilitet, në shoqërinë rajonale ujësjellës kanalizime Fier”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

Lori Musaj  
Smelaj Ahmetaj  
Ertica Myrtaj

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA PATOS**  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1888/3 Prot.

Patos më 04.07.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027”.

Ernesta Hamiti- Atëherë Plani Integritetit është një dokument strategjik i cili përcakton risqet kryesore të integritetit dhe masat që duhen marrë. Plani zbatohet nga administrata e bashkisë Patos, është plani tretë që ne po miratojmë në kuadër të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit.

Dy planet e para 2019-2022 dhe 2023-2025 kishin të parashikuara masat të cilat ne kemi marrë gjitha masat për ti zbatuar. Në përfundim të afatit të planit 2023-2025 grupi punës ka vlerësuar risqet sipas metodologjisë përkatëse dhe ka hartuar planin e veprimit për 3 vitet e ardhshme.

Planin e Integritetit dhe masat përkatëse jua kemi dërguar dhe janë bashkëlidhur.

Smerald Hazizaj- zv kryetar i komisionit të ligjeve- Plani i Integritetit ka kaluar në komisionin e ligjeve dhe është miratuar pa asnjë ndryshim me tre vota.

Faleminderit!

Armand Ahmetaj – Propozoj të kalojmë në votim e pikës së dhjetë Projekt-vendim “Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

Lori Musaj  
Smerald Hazizaj  
Erdita Myrtaj

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA PATOS**  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1893 Prot.  
13

Patos më 04.07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për një ndryshim të vendimit nr. 74, datë 28.10.2024, “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijëve administrativo-territoriale për Bashkinë Patos”.

Boreta Murati - Me vendim të Këshillit të Bashkisë me nr. 74, është miratuar Harta e përditësuar e kufijëve administrativo-territorialë për Bashkinë Patos sipas kërkesës së paraqitur nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ku kërkohet harta e përditësuar e kufijve administrativo-territorial, që përcakton standardet gjeohapësinore në kuptim të pikës 2, te nenit 93, të ligjit nr. 139/2015, i cili parashikon 5 rende kufijsh administrativo-territoriale.

Si domosdoshmëri për të patur një hartë të përditësuar të kufijve ndarës administrativo-territorial, është punuar harta për njësitë administrative (rendi 4) dhe fshatrave apo njësive të tjera në përbërje (rendi 5).

Me vendimin e mëparshëm është ndryshuar (Rendi 3) kufiri i territorit të Bashkisë Patos, gjë e cila nuk ndryshon me vendim të Këshillit të Bashkisë, por vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave sipas legjislacionit në fuqi.

Kam paraqitur hartat e reja të njësive administrative të Bashkisë Patos të treja Njësive Administrative:

Patos, Zharrëz, Ruzhdie, si dhe fshatrat përbërëse të të treja njësive administrative.

Për sa më sipër, i kërkojmë këshillit të bashkisë miratimin e ndryshimit të vendimit nr. 74, datë 28/10/2024 “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale për Bashkinë Patos”, hartës të ndarjes, për rendin 4 dhe rendin 5.

Artan Velçani- Komisioni Shërbimeve u mbledh ditën e enjte, u mor në shqyrtim kjo pikë dhe u vlersua në përputhje me legjislacionin dhe rregulloren dhe dha opinionin pozitiv për tu kaluar në këshill.

Novrus Toska – Me këtë ndryshim shtohet apo pakësohet kufiri territorit të Patosit?

Boreta Murati- Kufiri territorit nuk ndryshon ne kemi po të njëjtën sipërfaqe thjesht kemi bërë ndarjen e fshatrave të njësive administrative rendi katër dhe pesë.

Smerald Hazizaj- doja të dija vetëm një informacion nëse ka mundësi që në fshatin Rërës pasi është kufitare me fshatin Përballë, Patosin fshat e mar nga bashkia Fier ka pasur gjithmonë një problematikë të cilën kam pretenduar ose mund të jetë de facto që ka pasur mbivendosje të fshatit, Patosi fshat ka hyr në territorin e fshatit Rërës duke marrë tokë të konsiderueshme të fermerëve të Rërësit

Kryetari Bashkisë- Faleminderit Smerald!

Kjo është diçka që është në kompetencat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës më shumë se çmund të jetë të bashkisë. Duhet të jëtë një riazhornim që të përcaktohen qartë se ku janë pjesa e parcelave që të Patosit fshat janë në Rërës dhe të Rërësit janë në Patos Fshat. Ne e kemi dërguar për azhornim dhe presim përgjigje te kadastra dixhitale.

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje? Atëherë kalojmë në votim e pikës së njëmbëdhjetë Projekt-vendim “Për një ndryshim të vendimit nr. 74, datë 28.10.2024, “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijëve administrativo-territoriale për Bashkinë Patos”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE  
Refaela Xeba



Lori Musaj  
Smereta Hoxha  
Erika Myrtaj

KRYETAR  
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1944 / 4 Prot.

Patos më 09.07.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.06.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e blerjes së mjetit “autobetoniere për nevojat e Agjencisë së Shërbimeve Publike”.

Ermenita Mici - Dr Projekteve – Përshëndetje të gjithëve!

Ky projektvendim ka të bëjë me rëndësinë që ka aktualisht blerja një mjeti autobetoniere e cila do të vij në ndihmë Agjencisë së Shërbimeve Publike pasi bashkia patos aktualisht po zhvillon disa projekte njëkohësisht të cilat lidhen me projekte siç janë për shtrimin e trotuarëve, rehabilitimin e kanaleve kulluese, ndërtimin e kanaleve të ujërave të bardha, të zeza etj të cilët si pjesë të procedurës së ndërtimit dhe rehabilitimit të tyre kanë prodhimin e betonit aktualisht agjencia operon me betonieret të cilat kanë kapacitet të ulët rreth 0.25 dhe ky kapacitet i ulët përkthehet në kosto më të madhe në punëtori si dhe në kohë më të gjatë për kryerjen e procedurës.

Në këto kushte në e kemi parë të arsyeshme që prania e një mjeti autobetoniere do të bëjë të mundur reduktimin e këtyre kostove dhe shpenzimeve dhe në këtë mënyrë do të kryhet më tepër punë për të ardhur në ndihmë dhe për të plotësuar nevoja të qytetarëve

Fondi parashikuar për blerjen e mjetit autobetoniere është 5 milion lekë i cili do të financohet nga çlirimit fondit pas prokurimit të objektit të rikonstruksioni rrugëve të brendshme të bllokut të vreshtit.

Faleminderit!

Lori Musaj – Kryetare e komisionit të Ekonomisë– Në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe ky projektvendim të cilin e kemi argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe kemi votuar më katër vota pro.

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje? Atëhere kalojmë në votim e pikës së DYmbëdhjetë Projekt-vendim “Për miratimin e blerjes së mjetit “autobetoniere për nevojat e Agjencisë së Shërbimeve Publike”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

*Lori Musaj*  
*Smereta Hoxha*  
*Eshila Myrtaj*

KRYETAR  
Armand Ahmetaj